



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT LEZHË

**V E N D I M**

Nr. 50, datë 16.10.2015

**"PËR**

**NDRYSHIMIN E AKTIT TË THEMELIT TË AGJENCISË SË ZHVILLIMIT RAJONAL  
TË QARKUT LEZHË (AZHR-LEZHE)"**

Në mbështetje të Ligjit Nr 8652 date 30.07.2000 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore" i ndryshuar, Ligjin 8788 date 07.05.2001 "Për Organizatat jofitimpruese" i ndryshuar , Ligjin Nr 8789 date 07.05.2001" Për Rregjistrimin e Organizatave jofitimpruese", Vendimin e Këshillit të Qarkut Lezhë Nr 35 date 18.10.2013 "Për ngritjen e Agjensise së Zhvillimit Rajonal Lezhe" pika 5, Këshilli i Qarkut Lezhë në cilësinë e Personit Jurdik themelues të AZHR-Lezhe, pasi shqyrtoi dokumentacionin e funksionimit te Agjensise se Zhvillimit Rajonal Lezhe pas diskutimit të anëtareve,

**V E N D O S E**

1. Ndryshimin Aktit të Themelimit të Agjensise së Zhvillimit Rajonal Lezhë Nr 3839 Rep, Nr 1625 Kol i datës 09.12.2013 i nënshkruar pranë zyrës së Noterisë së Noteres Cetina Hoxhaj, dhe miratimin e Aktit të themelimit të ndryshuar sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij Vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Agjensia e Zhvillimit Lezhe për shërbimet që ofron do të financohet nga Buxheti i Këshillit të Qarkut Lezhe për një periudhe dy - vjecare, nga projekte të ndryshme apo institucione të huaja si dhe cdo burim tjetër të ligjshëm.
3. Akti i Themelimit i miratuar sipas pikës 1 të këtij Vendimi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhe. Kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhë ose një person i autorizuar prej tij do të kryejë të gjitha veprimet ligjore për rregjistrim.

Nr. 1523 Prot

Date 16.10 2015

4. Per zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Këshillit të Qarkut Lezhë
5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

SEKRETARI

Esmeralda NDOKA



KRYETARI

Gjok NDOKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT LEZHË

AKTI

I

THEMELIMIT I QËNDËR” AGJENSIA E ZHVILLIMIT RAJONAL LEZHË”

Në mbështetje të Ligjit Nr 8652 date 30.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”i ndryshuar , Ligjin 8788 date 07.05.2001 “Për Organizatat jofitimpruese” i ndryshuar , Ligjin Nr 8789 date 07.05.2001” Për Rregjistrimin e Organizatave jofitimpruese”, Vendimin e Këshillit të Qarkut Lezhë, Nr 47 date 16.10.2015 “Për Ndryshimin e aktit të themelimit dhe statutit të Agjencisë së Zhvillimit Rajonal të Qarkut Lezhë (AZHR-Lezhe)” miratuar Aktin e Themelimit si më poshtë:

**Neni 1**  
**Lloji dhe Emri**

U themelua “Agjensia e Zhvillimit Rajonal Lezhë” e llojit “Qëndër” ( AZHR –Lezhë ), organizate jofitimpruese dhe pa anëtarësi .Qendra vepron nën emrin: “ Agjensia e Zhvillimit Rajonal Lezhe”. Emërtimi i shkurtuar i Qendrës është: “AZHR - Lezhë”. Përveç emërtimit në gjuhën shqipe, shoqata do të përdorë edhe emërtimin në gjuhën angleze: “Lezha Regional Development Agency “LERDA ”. Vula përbehet nga akronimi në mes “LERDA” dhe rreth vult shkruhet Agjensia e Zhvillimit Rajonal Lezhë.

**Neni 2**  
**Selia e Agjensise**

Agjensia e Zhvillimit ka selinë administrative në Lezhë, në adresën: Pallati Nr 35, kati i tretë , Shëtitorja “ Gjergj Fishta”, Lezhë 4501,Albania, apo sipas rastit dhe mundësisë pasi të shprehet me shkrim themeluesi, Këshilli i Qarkut Lezhë. AZHR-ja Lezhë zhvillon veprimtarine saj në qytetin e Lezhës dhe mund të hapë degë të reja e të emërojnë përfaqësuesit e saj brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë sipas vendit dhe nevojës pas miratimit me vendim të Bordit i Drejtorëve dhe pëlqimit nga themeluesi, Këshilli i Qarkut Lezhë.

### **Neni 3** **Identiteti i Anëtareve Themelues**

3.1 Anëtari themelues i Agjensise së Zhvillimit Rajonal është: Këshilli i Qarkut Lezhë , përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhë z. Gjok Ndoka, shtetas Shqiptar i biri i Gjonit e i Diles, lindur me datë 28.07.1966 në Kurbën me adresë banimi në Lezhë Lagjia “ Frutore “, mbajtës i letërnjoftimit G60728043S

### **Neni 4** **Fusha e veprimtarisë**

4.1. Agjensia e zhvillimit Rajonal do të ketë si objektiv të veprimtarisë së saj :

- a) të udhëheqë, të lehtësojë dhe forcojë zhvillimin ekonomik të Qarkut Lezhë
- b) të jetë katalizator dhe kordinues për të gjitha projektet zhvillimore të rajonit të Lezhës;
- c) të zhvillojë kapacitetet institucionale drejt menaxhimit të proceseve të zhvillimit ekonomik
- d) të mbështesë rigjenerimin ekonomik dhe aktivitetet e zhvillimit rural
- e) të krijojë vende pune dhe të zhvillojë burimet njerëzore në rajon;
- f) të kontribuojë drejt arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm;
- g) të promovojë efikasitetin, investimet dhe konkurrueshmërinë e bizneseve.

4.2 . Detyrat e përgjegjesite:

- a) Koordinimi rajonal, komunikim dhe marrëdhëniet ndërinstitucionale
- b) Ndërtim i strategjise dhe programimit
- c) Menaxhimi dhe implementimi i programeve të zhvillimit rajonal
- d) Marketimi rajonal dhe promovimi , prezantimi i investimeve
- e) Promovimi i biznesit
- f) Transferimi i teknologjise se inovacionit
- g) Turizmi
- h) Bujqesia dhe zhvillimi rural

### **Neni 5** **Kohëzgjatja e veprimtarisë**

Agjensia e Zhvillimit Rajonal Lezhë krijohet për një afat të pacaktuar. Kohëzgjatja mund të kufizohet nga një vendim i motivuar dhe i autorizuar nga themeluesi. Kohëzgjatja e kufizuar mund të zgjatet përsëri me një vendim pasardhës, i motivuar dhe autorizuar nga themeluesi. Përfundimi i veprimtarisë së AZHR-se Lezhë mund të bëhet me vendim të themeluesit ose me Vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas kushteve të parashikuara në Ligj. Personaliteti juridik i AZHR-se mbaron në ditën kur vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për rregjistrimin e saj ka marrë formë të prerë.



## Neni 6

### Përsoni i autorizuar për ndjekjen e procedurave

Per ndjekjen e procedurave të nevojshme për regjistrimin e Agjensisë së Zhvillimit Rajonal në Gjykatën e Shkalles së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe për përfaqësimin e saj me të është Kryetari i Këshillit të Qarkut Lezhë , z. Gjok Ndoka ose nje person i autorizuar prej tij.

## Neni 7

7.1 Bordi i Drejtoreve është organi më i lartë vendimarrës së AZHR së Lezhë. Bordi përbëhet nga 3 ( tre) anëtarë të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Themeluesi i AZHR-se Lezhë, Këshilli i Qarkut Lezhë, për një periudhë 5 ( pesevjeçare) me të drejtë riemërimi.

7.2. Bordi i Drejtoreve përbëhet nga z. Gjok Ndoka, Kryetar i Bordit të Drejtoreve dhe dy anëtarë të tjerë të cilët emërohen nga Themeluesi i AZHR-se Lezhë.

7.3..Bordi i Drejtoreve ushtron kompetencat e tij në bazë të Ligjit, ndër të tjera dhe bën ndryshimin e Statutit të AZHR-së, përjashtuar nenit 19 të tij , i cili mund të ndryshohet vetëm me Vendim të Themeluesit, Këshilli i Qarkut Lezhë,

Akti i themelimit hartohet në pesë kopje origjinale në gjuhën shqipe ndër të cilat një kopje e mbajnë palet, një kopje depozitohet në regjistrin tregtar, QKR, një kopje në aktet e AZHR-së dhe një kopje pranë Zyres së Noterise ku do të noterizohet.

Kryetari i Keshillit të Qarkut Lezhë

